

VENDIM
Nr. 679, datë 10.11.2021

**PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, JOPUBLIK,
UNIVERSITETI “WESTERN BALKANS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18, 30 e 31, pika 1, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e institucionit të arsimit të lartë, jopublik, universiteti “*Western Balkans*” (në vijim, universiteti “*Western Balkans*”), në emër të shoqërisë “*Western Balkans University*” sh.p.k., i cili ushtron veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Universiteti “*Western Balkans*” organizohet në 3 (tri) fakultete:

- a) Fakulteti i Mjekësisë Dentare;
- b) Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;
- c) Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit.

3. Universiteti “*Western Balkans*” mund të ofrojë programe studimi në të gjitha ciklet e studimeve të arsimit të lartë, si edhe programe studimi me karakter profesional, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

4. Universiteti “*Western Balkans*” e fillon veprimtarinë e tij vetëm pas nxjerrjes së urdhrit të ministrit përgjegjës për arsimin për fillimin e veprimtarisë akademike.

5. Universiteti “*Western Balkans*” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional e të programeve të studimit brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

6. Statuti i universitetit “*Western Balkans*” miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

7. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontroll periodik të ligjshmërisë në institucion, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

8. Çdo ndryshim i njëjësive kryesore të universitetit “*Western Balkans*” miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, sipas legjislacionit në fuqi.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe shoqëria “*Western Balkans University*” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama